



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM
Nr. 59, datë 31.01.2023

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARES {...}, NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË NË NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 10, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtares znj. {...}, protokolluar me aktin nr. 197/30 prot., datë 20.1.2023, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR